

VENDIM
Nr.581, datë 28.5.2009

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2009, MIRATUAR PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR FINANCIMIN E SHPENZIMEVE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË 28 QERSHORIT TË VITIT 2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 12 të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në buxhetin e vitit 2009, për përballimin e shpenzimeve për zgjedhjet e 28 qershorit, t’i shtohet fondi 165 000 000 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekë, i ndarë, në zërat, si më poshtë vijon:

- 90 000 000 (nëntëdhjetë milionë) lekë, për paga e sigurime shoqërore e shëndetësore;
- 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, për mallra e shërbime;
- 65 000 000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekë, për t’ua shpërndarë subjekteve zgjedhore.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të viti 2009.

3. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha